

Xhaferi me familjen e vet jetontin në Podujevë/Podujevo, afër tjegullores. Me profesion ishte mësues dhe punonte në fshatrat e shumta në komunën e Podujevës/Podujevo. Nga viti 1977, punonte në Entin për Punësim në Podujevë/Podujevo. Në mëngjesin e datës **15.09.1998**, Xhaferi, nga tarraca e shtëpisë, kishte parë shtëpitë duke u djegur në fshatin e tij të lindjes në Dobratin/Dobrotin. Rreth orës 11:00, Xhaferi u nis me automobilin e vet të tipit *Golf* për në Dobratin/Dobrotin, për ta nxjerr nga fshati të vëllain Seferin dhe familjen e tij. Në drejtim të fshatit Dobratin/Dobrotin, po atë ditë, më 15.09.1998, nga Dumnica e Poshtme/Donje Dumnica, u nisën Ejup Sejdiu dhe Muhamet Fazliu, për ta nxjerr nënën e Ejupit, Nurijen. Ata u nisën me një veturë të ngjyrës së kuqe të Muhametit të markës *Askona*. Gjatë rrugës e takuan Rrahim Ramadanin, një i ri nga Dobratini/Dobrotin, dhe e morën me vete.

Pas tërheqjes së forcave serbe nga territori i Kaçandollit/Kaçandol dhe Dobratinit/Dobrotin, në shtëpinë e Fehmi Rekaliut, në *Mëhallën Lepaja* të fshatit **Bajçinë/Bajçina** [Podujevë/Podujevo], u gjetën mbetjet mortore të karbonizuara të Xhaferit, Muhametit, Ejupit dhe Rrahimit. Afër shtëpisë së djegur të Fehmi Rekaliut, është gjetur i shkatërruar *Golfi* i Xhaferit dhe *Askona* e djegur e Muhametit. Xhaferin e kishte identifikuar i biri Xhelili në bazë të një dhëmbi nga ari dhe dokumenteve personale, që kishin mbetur të padëmtuar. Xhaferin e kanë varrosur më 21.09.1998 në varrezat e *Mëhallës Lepaja* në Bajçinë/Bajçina.

Familjarët i kanë identifikuar Muhametin, Ejupin dhe Rrahimin në bazë të dhëmbëve dhe gjësendeve personale. Ata u varrosën më 21.09.1998 në varrezat e *Mëhallës Lepaja* në Bajçinë/Bajçina. Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur, në vitin 2005, i ka zhvarrosur mbetjet mortore të Ejupit dhe pas obduksionit të kryer, familjarët mbetjet mortore të tij i kanë rri-varrosur në varrezat në Bajçinë/Bajçina.

Burimet: deklarata V.F, FDH-11755; deklarata Xh.A, FDH-35228; deklarata Rr.L, FDH-36773; deklarata R.L, FDH-35228; *Tensions Run High in Podujeva Area, Many Missing and Feared*

Dead, pasqyra e lajmeve, KIC, 17.09.1998, FDH-29564; *Identity of Four Other Burned Albaninas in Podujeva Established*, pasqyra e lajmeve, KIC, 22.09.1998, FDH-29568; *Apperhension over Missing Albanians in Podujeva*, pasqyra e lajmeve, KIC, 17.09.1998, FDH-29564; *Two of the Six Burned Albaninas Identified*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.09.1998, FDH-29567; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297.

Mihane (Ferat Tashevci) Hyseni

(1923, shqiptare nga Kaçandolli/Kaçandol, komuna e Mitrovicës/ Kosovska Mitrovica, dy fëmijë)

Mihanja e moshuar jetonte vetëm në shtëpi të saj në **Kaçandoll/Kaçandol**. Rreth datës 10.09.1998, për vizitë i kishte ardhur e bija Sala nga Bajgora/Bajgora. Pas dy ditësh, ajo u nis për në shtëpi, Mihanja nuk deshë që ta braktisë shtëpinë dhe të nisete me të bijën. Trupin e Mihanës, të mbështjellë në një batanije, e kanë gjetur ushtarët e UÇK-së, pas tërheqjes së forcave serbe nga fshati më 18.09.1998. Ata i kishin thënë Salës se Mihanja ishte vvarrë më **16.09.1998**. E kanë varrosur në varrezat në Kaçandoll/Kaçandol, po atë ditë kur edhe Fetah dhe Jashar Behrami, si dhe Elez Begu.

Burimi: deklarata S.U, FDH-20935.

Ilaz (Bali) Hyseni

(26.08.1915, shqiptar nga Kaçandolli/Kaçandol, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, shtatë fëmijë, pensionist, pjesëtar i UÇK-së)

Ilazi para pensionimit kishte punuar në minierën *Trepça/Trepça*. Ai jetonte në Kaçandoll/Kaçandol, me të birin Ferizin dhe familjen e tij. Që të dytë, në qershor të vitit 1998, aderuan në UÇK. Në datën 15.09.1998, kur forcat serbe e kishin rrethuar fshatin **Kaçandoll/Kaçandol** dhe fshatrat përreth, Ilazi i kishte thënë familjarëve që ta braktisnin fshatin, ndërsa ai me ushtarë ndenji në fshat. Të nesërmen, më **16.09.1998**, forcat e shumta serbe kishin hyrë në fshat. Ilazi u tha bashkëlufëtareve të rinj se ai do të qëndronte në fshat. E vranë po atë ditë, në mbrëmje, në afërsi të shtëpisë dhe pranë urës. Pas dy ditësh, më 18.09.1998, Ferizi me ndihmën e disa ushtarëve të UÇK-së e